

### LEXIMET E ILUMINIZMIT NË EUROPËN LINDORE

Në botën e sotme, idetë qarkullojnë lirisht; një modernitet i marrë që prej shekullit të 18-të me lëvizjen Iluministe, lëvizje që u përqaftua në Shqipëri nga Lëvizja Kombëtare e Rilindjes. Veprat e mendjes, qofshin letrare, filozofike apo artistike nuk ndalen prej kufijve, por me gjithë entuziazmin që ngjall ky fakt mbetet problemi i pritjes dhe pritshmërisë së këtyre veprave në kohë dhe vende të ndryshme; veprat e iluminizmit janë të lexuara dhe të interpretuara në letrat shqipe, lexime dhe interpretime të ndryshme në kohë të ndryshme; dimë që *Kontrata Sociale* dhe *Emili* janë lidhur ngushtë me shumë shprehje politike, shoqërore, kulturore, sidomos gjatë periudhës së komunizmit të vendosur në këto vende. Rousseau-i dhe autorë të tjerë iluministë janë të pranishëm që nga shekulli i XIX-të në shume vende të Europës Lindore, si Poloni, Bullgari, Shqipëri, në planin pedagogjik, filozofik e letrar dhe, në një analizë të pritjes e të leximeve të veprës së tyre në këto vende, nuk mund të injorojmë veçorinë specifike e vështirësinë reale që përfaqëson secila kulturë si univers kuptimesh, i devijuar edhe prej historisë.

Konferenca mbi *Leximet e Iluminizmit në Europën Lindore* që u organizua në dhjetor të këtij viti, prej Qendrës së Studimeve Albanologjike, Departamentit të Studimeve Letrare, në bashkëpunim

të vijueshëm me Universitetin Montpellier III dhe Universitetin Sorbone IV, u prezantua në një formë dhe përmbajtje me objekt të dyfishtë: Shtirja në aspektin teorik, historik dhe politik të përkthimit të veprave të iluminizmit francez në vendet e lindjes dhe pritja, ndikimi e interpretimi i teksteve të tyre në letërsinë e këtyre vendeve në periudha dhe sisteme politike të ndryshme; për një analizë dhe histori të mendimit iluminist në letërsinë e vendeve të lindjes.

Në këtë kontekst problematika e ngritur synoi të sjellë vështrime dhe të vërtetojë hipoteza të reja, jo vetëm në fushën e teorive të përkthimit si “guri i këndit” për teorinë e letërsisë, por edhe të zgjerojë perspektivën e njohjes mbi ndikimin, pritjen dhe manipulimin e veprave të autorëve iluministë.

Njësimin e kësaj konference për kontekstin e studimit shqiptar, e realizuan tri parimet themelore epistemologjike të saj dhe tri problematikat që ajo ngriti: Në një plan të parë u ngrit hipoteza e ndikimit, përkimit, dhe pritjes së autorëve iluministë tek autorët dhe interpretuesit e historisë së letërsisë shqipe në periudha të ndryshme, por veçanërisht në periudhën e *Realizmit socialist*. Studimet mbi Realizmin Socialist pas rënies së tij janë të pakta dhe në kundërti me ç’mendohet, vëzhgimi i tij mbi

filozofët e iluminizmit francez është përdorur për propagandën politike të kohës brenda arsyes së saj praktike. Në një pikë të dytë u shfaq një interes empirik për përkufizimin e ideve, koncepteve të përdorura por edhe formave të përdorimit nëpërmjet manipulimit të teksteve të ndryshme të këtyre autorëve në letrat shqipe. Në një pikë të tretë u trajtuan burimet e këtyre ndikimeve, si edhe përdorimet e keqpërdorimet e tyre.

*Leximet e Iluminizmit në Europën Lindore*, treguan gjithashtu se asnjë kulturë nuk është e mbyllur në vetvete, e pakuptueshme dhe e vetëmjaftueshme. Këto lexime, këto kritika letrare, janë prova të mospërplasjes së kulturave, të shprehjes së tyre në një shumësi formash të jetës sociale, të zhvendosjes së tyre në forma dhe në

leksikë të tjerë. Asnjë vend nuk mund të pretendojë të zhvillohet i vetëm duke u kënaqur me historinë e tij: solidariteti midis kombeve sjell nevojën e kontakteve e të debateve.

Intelektualet, ndryshe nga dukjet, ishin në pararojë të kësaj lëvizjeje të bashkëkuptimit edhe kur diskutuan për tekste dyqind vjeçarë, të shkruar në momente të ndryshëm historikë dhe gjeografikë.

Historia e pritjes së Rousseau-it dhe Iluminizmit në Europën e Lindjes, falë disa studimeve dhe kërkimeve konkrete, mund të jetë shembulli i një enigme në dukje: përgatitja e së ardhmes, falë mësimave të së shkuarës. Aktet e kësaj konference janë objekt i një botimi të përbashkët midis Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Universitetit Montpellier III.

**Eriona TARTARI**